



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 15.11.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 14.11.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, **N.N.P "Wenda" nga Vushtrria**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrethojave dhe infrastrukturës në varrezat Janjevë" me Nr. të Prok: 613-22-10562-5-2-1

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **N.N.P "Wenda" nga Vushtrria**, të dt. 14.11.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrethojave dhe infrastrukturës në varrezat Janjevë", me nr. të Prok: 613-22-10562-5-2-1

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për Operatorin Ekonomik "Vali" shpk nga Suhareka. **Mbetet në fuqi** Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 07.11.2022

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **N.N.P "Wenda" nga Vushtrria**, me datë 14.11.2022 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrethojave dhe infrastrukturës në varrezat Janjevë" me nr. të Prok: 613-22-10562-5-2-1 ku këtë aktivitet AK ka shpallur fitues Operatorin Ekonomik "Vali" shpk nga Suhareka, **për shpërblim me kontratë** të datës 07.11.2022 dhe ka publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Operatori Ekonomik **N.N.P "Wenda" nga Vushtrria**, me datë. 14.11.2022 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i

rrethojave dhe infrastrukturës në varrezat Janjevë” Autoriteti Kontraktues, me datë 15.11.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sa i përket pretendimit tuaj të parë se Grup i Operatorëve Ekonomik STANDARD BETON SH.P.K.; Arifaj.shpk Dardani ,Rr.Beslidhja Nr.66, Prishtine është i pa përgjegjshën, ju informojmë se ky Grup i Operatorëve Ekonomik është i eliminuar dhe i njoftuar me letër standarde për çka mund të vërtetohet edhe në platformën elektronike e-prokurimi, andaj ky pretendim është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit tuaj të dytë se nuk kemi pas të drejtë të kërkojmë sqarim shtesë nga Operatori Ekonomik “Vali” shpk nga Suhareka, komisioni vlerësues i caktuar nga Autoriteti Kontraktues ka vepruar konformë nenit 38 për sqarimet e tendereve të Rregullores nr 001/2022 për Prokurimin Publik dhe si i tillë pretendimi i juaj për këtë pikë është i pabazuar.


AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Bekim Shabani


Drejtör i Prokurimit